

PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE PËR AKTIVITETIN:

Industria minerare

ID 3.6 “Minierat nëntokësore dhe veprimtaritë e lidhura me to”.

ID 3.7 “Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret”.

(sipas shtojcës 1 të Ligjit 52/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr.10448, datë 14.07.2011, të ndryshuar”)

SUBJEKTI: “YLBERI” Sh.p.k.

NIPT: K07729908J

VENDNDODHJA: Objekti “Maja Kunores”, Qafa e Burrelit, Qarku Dibër.

1. PROFILI I KOMPANISE

Subjekti “YLBერი” Sh.p.k. I regjistruar ne QKB me forme ligjore si Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuara, me NIPT K07729908J dhe administrator Ylber Çupi.

Subjekti do te aplikojte per leje mjedisi Tip B

Industria minerare;

ID 3.6 “Minierat nëntokësore dhe veprimtaritë e lidhura me to”.

ID 3.7 “Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret”.

Referuar shtojces 1 te ligjit 52/2020 “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.10448, DATË 14.7.2011, “PËR LEJET E MJEDISIT”, TË NDRYSHUAR.

2. OBJEKTIVAT E AKTIVITETIT:

- ❖ Objektivi i pare i ketij aktiviteti do te jete te identifikoje ndikimet e mundshme negative mjedisore ketij instalime te cilat jane:
 - Emetimet ne ajer dhe zhurmat;
 - Ndikimi ne flore/faune;
 - Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti i punetoreve;
 - Ndikime social-ekonomike;
 - Ndikim ne cilesine e jetes ne qendrat e banuara;
 - Ndikim ne rritjen e trafikut rrugor;
 - Ndikim ne peizazhin e zones;

- ❖ Objektivi i dyte i ketij aktiviteti eshte gjetja e alternativave qe jane me miqesore me mjedisin.

3. VENDNDODHJA E AKTIVITETIT

Subjekti do të zhvillojë aktivitetin e tij në adresën: *Objekti “Maja Kunores”, Qafa e Burrelit, Qarku Dibër.*

Pozicioni Gjeografik I Minieres

Objekti “Maja e Kunores” ndodhet në zonën e ish-Minieres së Klosit, 15 km larg qytezës së Klosit. Lidhet me degezim me rrugën automobilistike të Klos-Qafa e Burrelit, në pjesën perendimore të vendburimit krom-mbajtes Qafa e Burrelit.

Relievi

Relievi është relativisht malor dhe i thyer.

Klima

Zona në fjalë karakterizohet nga një klimë tipike kontinentale, me verë të shkurter të freskët e me reshje të pakta dhe me dimër të gjatë, të ftohtë e me reshje të bollshme.

Infrastruktura

Rruga automobilistike më e afërt është ajo e ish Minieres së Kromit, e cila lidhet me atë nacionale Burrel-Bulqizë.

Furnizimi me energji elektrike

Furnizimi me energji elektrike bëhet nga nënstacioni i Suçit.

4. IDENTIFIKIMI DHE VLERESIMIT I NDIKIMEVE NE MJEDIS

NDIKIME NE AJER

- ✓ Per sa i perket ajrit mund te kemi gjenerim te pluhurit ne nivele te ulta ne stinen e veres, por gjate procesit te shfrytezimit operatori do te sperkase me uje me qellim uljen e ketij impakti, por pa krijuar rrjedha ujore. Gjithashtu edhe mjetet mund te sjellin gjenerime ne ajer, per te cilat operatori do te kujdeset qe te mirembahen vazhdimisht duke i bere serviset perkatese duke parandaluar keshtu edhe avarit, pikimet apo rrjedhjet me pasoja ne toke dhe uje.

NDIKIME NE UJERA

- ✓ Prishja e cilesise te trupave ujore eshte identifikuar si nje ndikim negativ i mundshem, e cila mund te vije si rezultat i mosmenaxhimit te dherave ne kontakt me ujin e shiut, por operatori do ta perdore per rehabilitim sasine e dheut edhe pse eshte nje sasi teper e vogel.

NDIKIME NE TOKE

- ✓ Ngjeshja e tokes nga mjetet e renda mund te jete nje ndikim i mundshem, ose prishja e infrastruktures per te cilen operatori do te perdor sterilet (dheun) per rehabilitimin e vazhdueshem te saj.
- ✓ Ne kete aktivitet nje ndikim i cili mund te kanoset dhe eshte shume prezent ne aktivitete te tilla eshte erozioni, prezenca e te cilit mund te vije nga faktore te ndryshem. Per kete operatori do te shtoje siperfaqet e gjelberta dhe do te ndjeke me perpikmeri cdo lloj mase te propozuar nga inxhinier i karrieres.

ZHURMA DHE VIBRIME

- ✓ Zhurmat do ti kemi prezente ne kete aktivitetit nga proceset e punes, perdorimi I lendeve plasese dhe levizjes se mjeteve. Gjithesesi duke mare masa dhe duke i respektuar ato do te kemi minimizim te saj. Vlen te theksohet fakti se ne afersi te aktivitetit nuk kemi zona urbane.

MBETJE

- ✓ Mbetjet te cilat vijne si rezultat i aktivitetit te punonjesve do te grumbullohen ne kontiniere hermetik dhe do te depozitohen ne vendin e percaktuar nga NJQV, ndersa mbetje nga aktiviteti qe jane sterilet (dhe) do te depozitohen ne vendin e percaktuar dhe do te perdoren per rehabilitimin e argjinaures se shkalleve ose infrastruktures rrugore.

NDIKIME NE FLORE DHE FAUNE

- ✓ Zona ne te cilen ushtrohet aktiviteti eshte nje zone ne te cilen nuk takohen elemente te spikatur te flores dhe faunes. Perreth kesaj zone mund te hasim bimesi te ulet dhe barishte. Aspekti faunistik paraqet nje larmi biologjike te varfer. Zhvillimi I ketij aktiviteti nuk paraqet asnje ndikim negativ ne flore apo faune.

NDIKIM SOCIAL-EKONOMIK

- ✓ Me operimin e ketij aktiviteti pritet te kete nje impakt pozitiv ne ekonomine e qytetit ku zhvillohet aktiviteti. Operatori do te punesoje personel te zones, duke bere te mundur rritjen e nivelit ekonomik dhe te punesimit.

Subjekti
“YLBERI” SH.P.K.

Administrator
YLBER ÇUPI